

## **NJOFTIM PËR TARIFËN E SHKOLLIMIT PËR CIKLIN E PARË TË STUDIMEVE PËR VITIN AKADEMIK 2018-2019**

Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.778, datë 26.12.2018 “Për një ndryshim dhe shtesë në Vendimin nr. 288, datë 21.05.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kufirit maksimal të tarifës vjetore të shkollimit për studentët që ndjekin studimet në institucionet publike të arsimit të lartë, në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale me kohë të plotë”, të ndryshuar, Vendimit e Bordit të Administrimit nr. 4 datë 11.01.2019”Për disa ndryshime në Vendimin të Bordit të Administrimit nr. 22 datë 04.07.2018”Mbi miratimin e tarifave për aplikim, konkurim, regjistrim të fituesve dhe tarifave të shkollimit për të dy ciklet e studimeve, në UST” njoftohen të gjithë studentët që ndjekin studimet në të gjitha programet e ciklit të parë (program i parë) në Universitetin e Sporteve të Tiranës, **që do paguajnë 50% të vlerës së tarifës vjetore të shkollimit.**

**Tarifa vjetore për vitin akademik 2018-2019 do të jetë në vlerën prej 17 500lekë.**

**Duke qenë se jemi në pritje të shqyrtimit dhe të dokumentacionit të studentëve sipas Vendimit të BA 39 datë 27.12.2018(I publikuar [www.ust.edu.al](http://www.ust.edu.al)) që kanë aplikuar për përjashtim nga tarifa e shkollimit në vitin fund të vitit 2018 dhe kërkohet dokumentacion shtesë afati është deri në 30 Janar 2019, pagesa e tarifës vjetore për vitin akademik 2018-2019 do të jetë deri në 31 Mars 2019, fatura e pagesës do të shkarkohet nga sistemi, në muajin shkurt 2019.**

Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 779, datë 26.12.2018 “Për disa ndryshime në Vendimin nr. 269, datë 29.03.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit”, të ndryshuar, njoftohen të gjithë studentët që ndjekin studimet në të gjitha programet e ciklit të parë në Universitetin e Sporteve të Tiranës **që rezultojnë me notën mesatare vjetore 9 (nëntë) deri në 10 (dhjetë), përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit.**

**Për vitin akademik 2018-2019, përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit edhe studentët e pranuar në vitin e parë akademik, me note mesatare vjetore 9 (nëntë) deri në 10 (dhjetë), nga sistemi i arsimit të mesëm të lartë, të përlogaritur si mesatare e notave të të gjitha viteve të arsimit të mesëm të lartë, përfshirë edhe rezultatet e Maturës Shtetërore.(Sipas shkresës QSHA).**